

NEKROLOGJI

ALEKSANDËR STIPÇEVIQ

1930-2015

Më 30 gusht 2015 në Zagreb ndërroi jetë arkeologu , historiani, iliologu, bibliologu dhe mbi të gjitha patrioti dhe njeriu i madh Akademiku Aleksandar Stipçeviq. Ai ishte studiues i thellë në histori, bibliografi, enciklopedistikë dhe sociologji, por ka dhënë veçanërisht kontribut të rëndësishëm në fushën e iliologjisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.



Për shumë vjet drejtoi një varg institucionesh e projektsh që lidheshin me bibliotekat, historinë e librit, botimet enciklopedike etj., në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Jugosllavisë (JAZU) e më vonë të Kroacisë (HAZU) në Zagreb.

Aleksandër Stipçeviq lindi në fshatin Arbanasi të Zarës në Kroaci më 10 tetor të vitit 1930. Ishte njëri nga pasardhësit e arbëreshëve të rrethit të Shkodrës, të cilët 300 vjet më parë u shpërngulën në rrethin e Zarës.

Në vitin 1954 u diplomua në Fakultetin Filozofik të Zagrebit në degën e Arkeologjisë, ndërsa në vitin 1977 mbrojti tezën e doktoratës me titull “Simbolizmi religjioz tek ilirët” në Fakultetin Filozofik të Zarës. Një kohë punoi në Muzeun Arkeologjik të Zarës, kurse nga vitit 1957 u shpërngul në Zagreb dhe filloi punë në Bibliotekën Kombëtare e Universitare të atyshme. Në vitin 1974 mori postin e drejtorit në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Jugosllavisë (JAZU) në Zagreb, ndërsa prej vitit 1983 punoi në Entin Leksikografik Jugosllav (JLZ) “Miroslav Krleža” (Miroslav Krleža) po në këtë qytet.

Nga viti 1987 deri në vitin 1997 A.Stipçeviq ishte profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, Dega e Bibliotekarisë, të Universitetit të Zagrebit, ku mbante kursin e historisë së librit, sociologjisë së librit dhe

bibliografisë për ilirët, për censurën në biblioteka etj. Për më shumë se 50 vjet emri i tij identifikohet me rezultatet më të reja të studimeve ilire.

Veprimtaria shkencore e Aleksandër Stipçeviqit u zhvillua në disa drejtime, por dy prej tyre mbetën kryesore: arkeologjia dhe bibliologjia, dhe në këtë kuadër, gjatë karrierës së vet shkencore, kujdes të veçantë i kushtoi studimeve në fushën e ilirologjisë.

Veprimtaria shkencore – hulumtuese e profesorit të nderuar është e pasur me vlera dhe e gjerë për nga vëllimi. Në të bëjnë pjesë disa qindra punime shkencore e metodike të publikuara në gjuhën kroate, italiane, angleze, shqipe, si edhe një varg monografish shkencore e bibliografike, siç ishin: “Arte degli Illiri” (Arti ilir), Milano, 1963 (përkthyer në gjuhën angleze në vitin 1963), “Gli Illiri” (Ilirët), Milano, 1966 (botuar në gjuhën shqipe në vitin 1967), “Bibliographia Illyrica”, Sarajevo 1967, “Iliri – povijest, kultura, život” (Ilirët-historia, kultura, jeta), Zagreb 1974, 1989 dhe 1991 (botuar në gjuhën angleze në vitin 1977 dhe në gjuhën shqipe në vitet 1980, 1990 dhe 2002), Bibliografija antičke arheologije u Jugoslaviji 1-2” (Bibliografia e arkeologjisë antike në Jugosllavi), Sarajevo 1977, “Kultni simboli kod Ilira” (Simbolet e kultit të ilirët), Sarajevo 1981 (botuar në gjuhën shqipe në vitet 1983, 1990 dhe 2002), “Povijest knjige” (Historia e librit), Zagreb 1985 (botuar në gjuhën shqipe në vitin 1988 e 2000, në gjuhën arabe në vitin 1993 në Kuvajt, në persishte në vitin 1994, dhe i ribotuar në gjuhën arabe në vitin 2013 në Jordani). “Cenzura u knjižnicama” (Censura nëpër biblioteka), Zagreb 1992, “O savršenom cenzoru” (Mbi censorin e përkryer), Zagreb 1994 (botuar në gjuhën shqipe në vitin 2002), “Interpretime albanologjike”, Shkup 1994, “Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima” (Monumentet kulturo historike në Arbanasi), Zadar 1977, “Tradicijnska kultura zadarskih Arbanasa” (Kultura tradicionale e arbnesëve të Zarës), Zagreb 2011 (botuar në gjuhën shqipe në vitin 2012). Shumë nga veprat e sipërpërmendura u përkthyen në disa gjuhë botërore, ndërsa disa u përkthyen, së fundi, edhe në gjuhët shqipe, arabe dhe perse.

Në vitin 1983 profesor Stipçeviqi u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës (ASHAK), kurse prej vitit 2001 ishte anëtar i huaj (Socio straniero) i akademisë prestigjioze Accademia Marchigiana di Scienza, Lettere ed Arti, në Ankona të Italisë.

Në shenjë respekti dhe falënderimi për punën e tij shkencore, në vitin 2001 prof. Stipçeviqi u dekorua nga Presidenti i Shqipërisë z. Rexhep Mejdani me dekoratën e Artë “Naim Frashëri”, me motivacion për

kontributin në “Ndriçimin e historisë së ilirëve”, ndërsa më 3 shkurt 2015, respektivisht edhe me dekoratën “Skënderbeu” nga Presidenti B.Nishani.

Profesor Stipçeviq ishte aktiv deri në qershor të vitit 2014 kur iu desh të përballlej me përkeqësimin e shëndetit.

Aleksandër Stipçeviq ka qenë dhe mbetet një shkencëtar i madh, por mbi të gjitha, njeri i cili i kishte nderuar rrënjët e veta arbëreshe, kishte ruajtur gjuhën amë-arbëreshe, ishte mburrur me origjinën e tij dhe me punën e vet e nderoi mbarë kombin shqiptar.

Vdekja e profesorit Stipçeviq dhe akademikut të shquar është humbje e madhe për shqiptarët, për shkencën në përgjithësi, e posaçërisht për ilirologjinë. Por humbje duhet konsideruar edhe shitja e bibliotekës së tij të vlefshme shumë të pasur, për të përballuar shpenzimet e mjekimit të tij në vitin e fundit të jetës, që familja u detyrua ta bënte, sepse, ndër të tjera, mungoi interesimi shtetëror për këtë njeri të shquar nga qeveritë që do të ish dashur ta bënin këtë (Kroacia, Shqipëria e Kosova).

Borxhi i shqiptarëve për gjithçka ka bërë Stipçeviqi për kulturën e tyre, mbetet i madh.

Duhet theksuar se profesori Stipçeviq asnjëherë nuk e harroi gjuhën arbëreshe dhe origjinën e vet. Aq sa bëri me pendë ky ambasador dhe promotor i kulturës kombëtare shqiptare, e bëri edhe duke ndihmuar profesionalisht dhe në çdo aspekt tjetër shumë shqiptarë kur ata kishin nevojë, dhe ky është një nga gurët në monumentin që ai ia ngriti vetes për së gjalli.

**NASER FERRI
MARENGLLEN VERLI**

